



ISTOGU I BUKUR

*Tregime për trashëgiminë kulturore dhe
natyrore të interpretuara nga nxënësit*

Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” mundësuar nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor - ReLOaD financuar nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

ISTOГУ IM I BUKUR

*Tregime për
trashëgiminë
kulturore dhe
natyrore të
interpretuara nga
nxënësit*

Autor: GUIDEKS – Asociacioni i
Guidave Turistike të Kosovës

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94,
Prizren &
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1
Nr.5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Fotografitë: Të gjitha fotografitë
e këtij publikimi janë bërë nga
SK PICTURES, përpos këtyre
fotografive: Databaza e
trashëgimisë kulturore (fq.11 dhe
fq.75), Klubi Alpin Podguri
(fq.65), Shkelzen Rexha (fq.73
dhe 79)

Qershor, 2020

Autorë të tregimeve të këtij publikimi janë të gjithë nxënësit e renditur më poshtë sipas rendit alfabetik përfshi edhe informata për shkollën e tyre, fshatin/qytetin, klasën dhe numrin e faqes së tregimit.

Agnesa Mehmetaj	SHFMU "Avni Rrustemi" Zallq	Kl.8 Fq.26
Alketa Zymeraj	SHFMU "Trepça" Banjë	Kl.6 Fq.24
Amanda Bicaj	SHFMU "Hysni Zajmi" - Vrellë	Kl.7 Fq.43
Anisa Haliti	Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog	Kl.12 Fq.30
Arbina Selmanaj	SHFMU "Zymer Zekaj" Kaliqan	Kl.8 Fq.14
Arguriana Osmanaj	SHFMU "Trepça" Banjë	Kl.6 Fq.58
Diona Avdylaj	SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë	Kl.7 Fq.56
Dorentina Arifaj	SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh	Kl.8 Fq.28
Edi Mavraj	SHFMU "Ismail Qemali" Saradran	Kl.7 Fq.20
Edona Seferaj	SHFMU "Tre Dëshmoret" Uçë	Kl.8 Fq.44
Elbiona Nicaj	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Kl.9 Fq.46
Enisa Haxhijaj	SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh	Kl./ Fq.60
Erona Isufaj	SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc	Kl.6 Fq.55
Erza Hajzeraj	SHFMU "Tre Dëshmoret" Uçë	Kl.7 Fq.32
Fjolla Rugova	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Kl.6 Fq.62

Florent Balaj	SHFMU "Fan Noli" Llukavc i Begut	Kl.7 Fq.34
Florentina Dervishaj	SHFMU "Avni Rrustemi" Zallq	Kl.8 Fq.36
Gledon Avdijaj	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Kl.9 Fq.38
Hala Mavraj	SHFMU "Ismail Qemali" Saradran	Kl.9 Fq.40
Jetjon Zekaj	SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë	Kl.6 Fq.16
Kaltrina Çetaj	SHFMU "Ismail Qemali" Saradran	Kl.6 Fq.64
Leona Imeraj	SHMT "Mit'hat Frashëri"- Gurrakoc	Kl.11 Fq.52
Rinesa Zogaj	SHFMU "Zymer Zekaj" Kaliqan	Kl.8 Fq.48
Sherif Metaj	SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh	Kl.9 Fq.66
Valza, Endrion dhe Art Visoqi	SHFMU "Fan Noli" Llukavc i Begut	Kl.7 Fq.68
Valëza Demaj	SHFMU "Hysni Zajmi" - Vrellë	Kl.7 Fq.50
Vesa Kameraj	SHFMU "Tre Dëshmoret" Uçë	Kl./ Fq.54
Vesa Vuthaj	SHMT "Mit'hat Frashëri"- Gurrakoc	Kl.11 Fq.18
Zanfina Sahitaj	SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë	Kl.7 Fq.70

Autorët e tregimeve janë të gjithë nxënësit e lartshënuar përderisa renditja, plotësimi dhe redaktimi i tyre është bërë nga GUIDEKS.

Parathënie

Disa libra flasin me përmbajtjen e tyre, të tjerat tregojnë storie përmes rrethanave në të cilat janë krijuar ato. Përkundër disa besimeve të zakonshme, tregimet nuk kanë për qëllim të ndajnë – gjuhët, komunitetet, kombet, gjinitë – por ato janë aty për të bashkuar: për të treguar barazinë e vlerave tona, por edhe për të bashkuar nganjëherë raportet e humbura njerëzore në mes nesh.

Librin që keni në dorën tuaj përmban gjithsej 40 tregime të interpretuara të nxënësve për trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Komunës së Istogut. Libri paraqet një perspektivë, këndvështrim të një nxëneseje apo nxënësi se si e sheh dhe e përjeton trashëgiminë kulturore që e rrethon. Këto tregime janë mbledhur përmes një procesi të hapur konkurrues ku kanë marrë pjesë shumë të rinj e të reja nga kjo komunë dhe tanimë, tregimet më të mira janë përmbledhur në kapitujt në vijim.

Tregimet janë grupuar në pesë tematika të renditura si në vijim:

1. Hyrja me përshkrim në Komunë të Istogut rreth potencialeve turitike dhe lokalitetet gjetjet arkeologjike;
2. Trashëgimia e luajtshme ku janë të përfshira artefaktet e rëndësishme dhe muzeu i qytetit;
3. Trashëgimia e paluajtshme ku përshkruhen monumentet arkitektonike si kullat, xhamitë, kishat, mullinj të, etj;
4. Trashëgimia natyrore ku listohen disa nga potencialet e rëndësishme natyrore; dhe

5. Trashëgimia shpirtërore me disa nga elementet e rëndësishme të dokeve e zakoneve përfshi edhe veshjet e ushqimin tradicional.

Ky libër mund të shërbejë si material informues mbi trashëgiminë kulturore dhe historike të Istogut dhe si i tillë do të shpërndahet edhe në shkollat e kësaj komune dhe njëkohësisht do të promovohet si material për zhvillim të turizmit të kësaj komune me natyrë të bukur e histori të pasur. Mos gjykoni tregimet e tyre nga këndvështrimi historik apo profesional pasi që qëllimi i këtij libri nuk është aty. Përkundrazi, ky projekt shërben si inkurajim për të rinjtë tjerë të japin më shumë dhe të punojnë në tregimet tjera në mënyrë që të plotësohet mozaiku i pasur i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Istogut.

Tregimet, nuk mund të imagjinohen pa procesin interaktiv mes njerëzve, p.sh. mes një gjyshi/gjysheje dhe mbese/nipi apo edhe mes miqsh. Tregimi merr kuptim dhe bën histori vetëm nëse ju e transformoni atë në një tregim të cilën e ndani me të tjerët! Duke transformuar historinë individuale në storie të cilën e keni ndarë me të tjerët, ne të gjithë e krijojmë historinë tonë të përbashkët. Përmes këtij procesi, ne nuk e respektojmë dhe nuk e mbajmë gjallë vetëm trashëgiminë tonë, por edhe e transmetojmë tek gjeneratat e ardhshme pas nesh.

Ju dëshirojmë rrugëtim e lexim të këndshëm në Istog,

Ekipi i projektit



1. Një vizitë në Istog

Sot lëvizjet e njerëzve në tërë globin janë për motive të ndryshme, interesa të veçanta dhe për qëllime të ndryshme. Në botë kemi një lëvizje të madhe të njerëzve që udhetojnë – lëvizin me qëllim vizite dhe njohje me vende të reja turistike.

Si pasuri të vendit tim unë nuk konsideroj atë se sa të pasur jemi ekonomikisht apo financiarisht, por konsideroj se vendi im është i pasur me shumë pasuri natyrore që vet Zoti i ka krijuar. Si pasuri tjetër e vlerësuar janë vlerat materiale e shpirtërore të trashëguara nga paraardhësit tanë e që ne sot i gëzojmë. Pra, trashëgiminë natyrore e kemi nga nëna natyrë por që obligohemi që ta ruajmë ta mbrojmë çdo cep të saj, sepse kemi edhe obligim ndaj brezave tjerë. Ndërsa trashëgiminë kulturo – historike dhe gjithë vlerat e saj kulturore, historike, shpirtërore, estetike e materiale i kemi të krijuara e të trashëguara nga paraardhësit tanë.

Komuna e Istogut ka një terren që mundëson vizita turistike pothuajse në të gjitha llojet e turizmit. Veçojmë turizmin malor ku një vizitor do të mund të kënaqej me bukurit e bjeshkëve të Istogut, të cilat janë të pasura dhe me vlera të larta ekologjike; me forma të ndryshme, me florë e

faunë, peizazhe të bukura, me gryka e burime, monumente natyrore si shpella, livadhe e burime. Po ashtu është i mundur turizmi transit, turizmi shëndetësor, ku veçojmë Banjën e Pejës, ku shumë njerëz vijnë për nevoja shëndetësore. Më pas mund të veçojmë turizmin kulturor, ku rajoni i Podgurit ka një trashëgimi kulturore mjaft të pasur, e sidomos atë arkitekturore, ku me interes të veçantë janë kullat, mullinjtë, xhamitë, hambarët etj. Ngado që ka lumenj dhe rrjedhë të lumenjve hasim në mullinjtë prej ujit, zonë kjo e dalluar në të kaluarën me një numër shumë të madh të mullinjve përgjatë rrjedhave lumore. Andaj trashëgimia e vendit tonë është simbol i rëndësishëm që tregon vlerat materiale e shpirtërore të krijuara ndër shekuj.

Istogu duke pasur edhe një numër të madh të fshatrave, gjithsej 49, ofron edhe turizmin rural, i cili kohëve të fundit është shumë i kërkuar në oferta turistike. Këtu nuk mund të përjashtojmë edhe gastronominë e cila është pjesë përbërëse e kulturës së kësaj ane.

Fotografite anash: Kulla e Sali Osman Bicit në Vrellë; peisazh natyror në Komunë të Istogut; Burimi i Istogut; Artefakte në Muzeun e Istogut.



2. Istogu i lashtë

Kosova llogaritet si një nga vendet me pasuri të trashëgimisë kulturore e sidomos asaj arkeologjike e cila zë një vend të rëndësishëm në historinë e kulturës sonë. Populli ynë, është ndër popujt më të vjetër në Evropë, duke u shtrirë në territorin Ilirik që dëshmohet me një kulturë të zhvilluar të dallueshme dhe të veçantë.

Istogu duke qenë i vendosur në një zonë të përshtatshme kishte të gjitha parakushtet e nevojshme **për t'u zhvilluar jeta** që nga parahistoria apo themi që nga koha e gurit të vonë (Neolitit) e deri në Mesjetën e zhvilluar apo të vonë, për të ekzistuar deri më sot. Kushtet e mira gjeografike duke u mbizotëruar nga një reliev i ndryshueshëm i cili në përbërjen e tij ka malet e larta të Mognës ku majat kapin lartësi mbi 2000 metra, po ashtu relieve fushore dhe pjesërisht kodrinore-malore.

Kjo zonë njihet edhe për rrjedhën e pasur të ujërave, të lumenjve, përroskave e sidomos të burimeve të ujërave termale dhe termo-minerale. Gjithashtu kushtet e mira klimatike, tokat mjaft pjellore dhe shumë elemente të tjera kanë bërë të mundur zhvillimin e qendrave të banuara që nga periudha e neolitit të vonë për të vazhduar deri në ditët e stome.

Këtë fakt e tregojnë shumë gjetje arkeologjike, zona të evidentuara arkeologjike e të dokumentuara

nga shumë përshkrues, hulumtues e studime të kësaj zone që janë bërë në shek. XIX dhe XX.

Komuna e Istogut sot ka 49 fshatra duke e shtuar edhe qendrën e urbanizuar të Istogut, me një sipërfaqe relativisht të madhe në krahasim me komunat tjera të rangut të saj. Të dhënat e para i gjejmë tek udhëpërshkruesit e huaj në shek. XIX dhe XX, mirëpo kërkimet e para arkeologjike i gjejmë në pjesën e dytë të shek. XX.

Në disa vende/fshatra të Komunës së Istogut zbulohen edhe gjetjet e para. Disa prej tyre janë gjetje rasti, ndërsa të tjera gërmime me karakter shpëtimi në ato raste kur janë bërë punime të ndryshme. Fshati i sotëm Rakosh kishte rezultuar me disa gjetje të periudhës së Neolitit të hershëm, për të vazhduar më pas edhe në vende të tjera me gjetje të cilat sa përfaqësonin periudhat e ndryshme që përfaqësonin dhe prezantonin prezencën dhe krijimtarinë e popullit Iliro-Dardan, gjithashtu duke pasqyruar edhe jetën e tyre e që raste-raste kishte edhe elemente aristokratike e princërore. Komuna e Istogut në këtë aspekt prezantohet mirë dhe evidentohet me një numër relativisht të mirë të lokaliteteve me gjurmë të lashta e historike.

Fotografite anash: Lokalitet arkeologjik në Studenicë.



3. Përkrenarja ime

Trualli në të cilin jetuan me mijëra vjet më parë paraardhësit tanë – Ilirët, ka ruajtur gjurmët e qytetërimit të trashëgimisë së tyre duke kaluar kështu nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit. Në këtë truall bënë pjesë edhe komuna jonë, Istogu.

Përkrenarja ime është sa krenare aq edhe fisnike, e bukur dhe elegante, mbi gjitha simbol i qëndresës dhe mbijetesës. Por **ç'janë në të vërtetë përkrenaret?!** Përkrenaret ilire ishin pjesë e armatimit të luftëtarëve të cilët ishin më të pasur për nga standardi, pra me fjalë të tjera përkrenaret janë kapele me funksion për mbrojtje gjatë luftimeve. Në tërë territorin e Ilirisë janë gjetur shumë ekzemplarë të përkrenareve të cilat janë gjetur nëpër varreza luftëtarësh. Përkrenarja ime, ishte toka e Kosovës, ishte dheu i Banjës së Pejës, vatër kjo e pasurive të shumta kulturore e natyrore, vatër e ruajtjes së kaluarës tonë historike. Kjo vatër që me mijëra vite mbajti të ngjizur nën dheun e saj shumë vlera të autenticitetit tonë shqiptar.

Këto dhe shumë të tjera flasin për të kaluarën tonë të mundimshme e të përgjakshme por asnjëherë të humbur e të tretur. Një nga pasuritë e shumta janë edhe përkrenaret ilire, përkrenare këto që dolën në dritën e diellit pas mijëra vitesh, për të na treguar krenarinë dhe fisnikërinë e paraardhësve tanë.

Ishin vitet e 70-ta, ku në saje të disa gërmimeve me karakter shpëtimi, pikërisht në kohën e ndërtimit të një objekti hotelier, hasën në gjurmë të lashta dhe që rezultoi me shumë gjetje të veçanta të kohës së hekurit. Pikërisht këtu u gjeten 3 ekzemplarë të Përkrenares Ilire të cilat ishin të punuara nga bronzi. Po këtu u gjeten edhe shumë materiale të tjera me vlera të veçanta si: armë, vegla, stoli, enë prej argjile, maja heshtash, enë me figura të zeza, etj. Këto gjetje u zbuluan në varreza të burrave dhe të grave. Në varret e burrave, e sidomos të luftëtarëve u gjetën përkrenaret, armët dhe majat e heshtave përdërisa në varret që u përkisnin grave u gjetën: stoli, byzylykë, etj.

Përkrenarja ime: Banja e Pejës, mbijetove shumë betejave njëherit duke u bërë pjesë e pa ndarë e atyre luftëtarëve të zot iliro-dardan. Ti mjaft mirë i mbijetove edhe kohës duke u fshehur nën dheun e kësaj toke, ku edhe të ruajti për mijëra vite e së bashku me ty e ruajti edhe kulturën, krijimtarinë dhe lashtësinë dardane, të ruajti deri në kohën tonë, ku ne sot jemi krenarë.

Sot, Muzeu i Kosovës në koleksionin e saj e ka të ekspozuar këtë përkrenare.



4. Muzeu i Istogut

Kultura, historia, gjësendet e vjetra, mjetet dhe materialet e ndryshme të paraardhësve tanë e bëjnë një vend të veçantë. Vendi ku ruhen këto gjëra historike dhe të vlefshme është muzeu. Rëndësia e një vendi bën që të rritet edhe dashuria për të. Me këtë tregim, unë do të mundohem të shkruaj për muzeun e qytetit tim në Istog.

Muzeu që ruan gjësende me vlera të mëdha historike, arkeologjike e kulturore, vërtetë ta shton dashurinë për kulturën tonë shqiptare. Në muze kemi prezantim të veshjeve origjinale Ilire që transmetojnë shumë elemente që vijnë nga lashtësia, e që në dukje ishin shumë të veçanta. Po ashtu kishte gjësende që prej kohës së gurit (Neolitit) e deri në kohëra tona e që secili prej tyre kishte një tregim më vete.

Gjatë vështrimit të këtyre perlave kulturore të ruajtura që i kemi trashëguar nga paraardhësit, vura re një fotografi ku shfaqeshin disa stoli të princeshës ilire. U ndjeva shumë krenare që qyteti im ka në dorë një thesar të tillë. Ajo që më la mbresa të mëdha po ashtu ishte paraqitja e plotë e odës tradicionale shqiptare. Isha shumë me fat që mund të shihja nga afër se si në të vërtetë ka qenë e mobiluar një odë shqiptare e cila në të kaluarën cilësohej si dhoma

më e mirë e shtëpisë ku janë diskutuar problemet e ndryshme politike dhe në një kohë janë përdorur edhe për të zhvilluar mësimet.

Në muze gjendej edhe një element i kuzhinës shqiptare dhe mikpritjes, sofra, e cila shërbente si tryezë e kishte formë të rrumbullakët nga druri në të cilën familjarët e miqtë uleshin në mënyrë të përbashkët. Sofra është element që shpreh më së miri mikpritjen e popullit shqiptar. Këto dhe shumë elemente materiale të kulturës sonë të vjetër dhe të veçantë ishin të vendosura dhe të ruajtura mjaft mirë.

Pas kësaj vizite në Muzeun e qytetit të Istogut, u binda dhe u ndava shumë e kënaqur që vendi im kishte një histori interesante me shumë thesare kulturore.



5. Guri tek kroi i vjetër

Unë jetoj në fshatin Shushicë e cila nuk ndodhet shumë larg qendrës së qytetit të Istogut, rreth 8 kilometra në lindje të saj.

Pikërisht në lagjen time diku në vitin 2015 është zbuluar një gur i cili po del së është mjaft i vjetër. Ky gur ka një gjatësi rreth 1.3 metra. Vend-gjetja e tij e këtij guri është tek "Kroi i vjetër", për të cilin krua janë përkujdesur paraardhësit e mi duke e ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi.

Si dëshmi që tregon se ky guri është i vjetër tregojnë edhe gdhendjet e tij që gjenden në sipërfaqen e gurit. Aty gjejmë një yll, pemën e jetës dhe lulen e jetës. Këtë gur e ka gjetur një bashkëvendës i yni në mënyrë rastësore ku e njëjta është dërguar në Muzeun e qytetit në Istog. Këtë gur ne e konsiderojmë me shumë vlerë për lagjen dhe fshatin për arsye se ka shumë vlera që tregojnë për vjetërsinë dhe krijimtarinë e popullit tonë.

Sot fatkeqësisht hapësira dhe vetë vendi ku gjendet kroi është shumë i papastër. Kjo vjen si rezultat i mos kujdesit të vetë banorëve dhe njerëzve që shpesh e frekuentojnë këtë vend.

Uji ku buron ka gurë të mëdhenj dhe për këtë fakt uji është shumë i pastër, i cili përdoret nga banorët

për ujitjen e livadheve apo edhe tokave bujqësore. Pra, në një aspekt ky kroi ka lehtësuar punët në punimin e tokave që gjenden në afërsi.

Ky gur dhe kroi është vetëm një nga pasuritë e shumta që kemi ne si fshat por edhe si popull shqiptar, andaj dëshira ime është që ne si banorë të fshatit të punojmë shumë në përkujdesjen e këtyre vendeve që të mos i shkatërrojmë e njëherit edhe ne të mundohemi e ti përcjellim tek brezat e tjerë. Po ashtu këto elemente tregojnë se ne duhet të vazhdojmë të gjurmojmë e hulumtojmë sepse në këto hapësira mund të ketë ende vlera të këtilla.



6. Kulla e familjes

Rugova

Istogu është vend i bukur me bjeshkë e fshatra të mira, ku një prej tyre është edhe fshati Llukavc.

Në këtë fshat të bukur gjendet një kullë historike ngase ndërtimi i saj ka filluar në fillim të shekullit XX apo në vitin 1910 dhe ndërtimi i saj ka zgjatur diku rreth 30 vite. Kjo është kulla ku është rritur Ibrahim Rugova, presidenti ynë i ndjerë. Pas vdekjes së babait të tij, gjersa ishte foshnje, ai së bashku me nënën e tij shkuan tek Kulla e Qerim Rugovës për të jetuar deri në moshën 18 vjeçare deri sa filloi studimet në Prishtinë.

Kulla në Llukavc është e ndërtuar me gurë dhe në një mënyrë të veçantë dhe autoktone. Numëron plot 8 dhoma. U deshën 30 vite për ta ndërtuar, ngasë në atë kohë nuk ishin kushtet dhe materialet adekuate për ndërtimin e saj.

Pas luftës së fundit në Kosovë është dashur kohë për ta renovuar kullën pasi që e njëjta ishte e shkatërruar gati tërësisht. Vonesa e renovimit është për keqardhje, ngase në një kullë në të cilën është rritur një njëri si Rugova meritonte një trajtim dhe përkujdesje më të mirë.

Kjo kullë por edhe monumentet e tjera që ngelën nga të parët tanë janë dëshmi e traditës, origjinës, historisë dhe kulturës që na lidhë me të shkuarën. Madhështinë e kësaj kulle ia shton historia e saj, kujtimet e shumta dhe harmonia në familjen Rugova. Ndaj nuk duhet harruar se këto janë trashëgimi kulturore që mbajnë në këmbë identitetin kombëtar.

Duhet të bëjmë gjithçka për të kthyer vëmendjen sërish nga këto monumente të çmuara historike **për t'i treguar botës se nga vijmë** dhe se ende e ruajmë origjinën tonë sepse ne jemi gjenerata që po rritet, rruga drejtë së ardhmes, një e ardhme që mundë të jetë më e mirë!



7. Kulla e Hetem Beqë Mavraj

Gjithnjë kam pasur dëshirë të shkruaj për vendlindjen time, Saradranin.

Unë do të ju tregoj për Kullën e Hetem Mavrajt e cila gjendet në lagjen time dhe sot është e braktisur.

Kjo kullë është e ndërtuar sipas traditave shqiptare dhe e tëra është e ndërtuar në gur. Guri i përdorur në strukturën e tij i jep një pamje mjaft të bukur kullës. Po ashtu ne, fëmijët e lagjes gjatë rrugës për në shkollë, duke e shikuar atë, na bënte të hulumtojmë shumë më shumë për kullën, traditat dhe arkitekturën shqiptare ndër vite.

Kjo kullë, siç më ka treguar babai im është shumë e vjetër, më shumë se 100 vite, pasi që shumica e kullave në këtë rajon janë nga e njëjta periudhë. Gjithashtu këtë kullë e bënë me rëndësi të veçantë dy nga fragmentet epigrafike, gjegjësisht dorëshkrime të cilat i hasim në hyrje të cilat gjenden të murosurat në gurët e qemerit hyrës, pra të portës së kullës.

Banorët e lagjes thonë se ato dorëshkrime janë nga shekulli i II dhe III dhe kanë vlerë shumë të mëdha historike dhe për këtë fakt duhet ruajtur me kujdes të veçantë. Këto fragmente janë

evidentuar edhe nga institucionet tona, andaj në bazë të kësaj ne mund të themi se fshati ynë është mjaft i lashtë pasi që këtu gjenden gjurmë të vjetra siç është rasti me pllakat që janë këtu.

Këtë kullë dhe shumë monumente të tjera i kemi të trashëguara nga paraardhësit tanë. Ne obligohemi **që t'i ruajmë, mbrojmë dhe t'ua përcjellim gjeneratave të tjera.**

*Pëshrkimi i fotove anash:
Fragmenti i altarit: a) pllaka e mermerit të bardhë me përmasat 23x15cm dhe b) mermeri me përmasa 17x23,5 cm dhe lartësi të germave 4cm me shkrimin për hyun Merkuri dhe emrin e dedikuesit Ulp(ius) Viat(or). Të dy këto fragment janë pjesë e altarit dhe i përkasin periudhës romake (shek.II-III)*



8. Kulla e Avdurrahman Ramë Kajtazit

Në fshatin Lubovë, ekziston një kullë në Lagjen e Kajtazve, kullë banimi e njohur tek vendoret si kulla e Kajtazve që në afërsi ka edhe kullën e Qazim Bekës.

Ky ndërtim u realizua nga mjeshtrit e shkollës shqipe Kosovare dhe Dibrane në vitin 1856 dhe është e ndërtuar në tre kate. Është e ndërtuar nga guri dhe druri me llaq gëlqeror dhe e mbuluar me tjegulla tradicionale. Kulla ka qenë e njohur si vendqëndrim (jatak) i shumë patriotëve të kësaj ane si dhe shumë figurave historike si Haxhi Zeka, Azem Galica, etj, të cilët mbanin tubime historike për rezistencën shqiptare kundër pushtuesve.

Deri para luftës së fundit të vitit 1999, kjo kullë është përdoruar për banimi familjar dhe si Odë e fshatit. Sot nuk përdoret për banim pasi është djegur dhe granatuar në luftë.

Gjatë vitit 2010, kjo kullë ishte dëmtuar edhe nga era e madhe që kaploi Komunën e Istogut ku edhe çatia e kullës u shkatërrua.





9. Mulliri i

Baicës

Mulliri i Baicës thuhet së është mbi 100 vite i vjetër mirëpo nuk dihet saktë data apo viti i ndërtimit. Ai sot qëndron ende mbi themelet e tija të forta.

Ky mulli i ka shërbyer për shumë vite fshatit Baicë por edhe fshatrave përreth sikurse: Dubova, Vitomerica, Saradrani, Lubova, Kashica, etj. Bluarja e misrit ishte falas dhe plotësisht në shërbim të banorëve pasi që burimi kryesor për rrotullimin e gurit të mullirit ishte uji i cili ishte burim i pashtershëm.

Mulliri ishte funksional edhe pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë në një periudhë relativisht të shkurtë për të dale jashtë funksionit më pas. Mulliri i Baicës për nga pamja e jashtme është shumë i bukur.

Tani edhe pse është jashtë funksionit të tij primar, lirisht mund të themi se ai është një vlerë e trashëgimisë sonë kulturore, duke na treguar kështu jetesën e stërgjyshërve tanë.

Ky mulli në strukturën bazë të ndërtimit e ka gurin, duke na dhënë dëshmi së është mjaft i vjetër. Këtë e them me plot siguri sepse edhe stërgjyshi im ka bluar misrin në këtë mulli.

Ky mulli është mulli uji, që përdorte rrjedhën e lumit të Drinit të Bardhë. Në këtë mulli punonte Sali Morinaj i cili ishte edhe pronari i mullirit. Dem Morinaj, djali i pronarit, ndihmonte po ashtu me punët dhe nevojat që kishte mulliri.



10. Mejtepi në Zallq

Mejtepi filloi ndërtimin në vitet 1945-46 përderisa u hap në vitin 1948. Ky mejtep ka qenë burim i diturisë për shumë njerëz. Ka qenë shtëpi dhe shkollë, e tani është një vend shumë i rëndësishëm edhe për ne.

Kjo shkollë, ka shkolluar gjyshërit tanë ku edhe i kanë mësuar shkronjat e para dhe mësimet për jetën. Mësimi ishte i fokusuar më shumë në shkrim lexim të gjuhës shqipe. Ky mejtep, po ashtu ka simbolizuar lirinë për shumë njerëz. Ka qenë vendi ku janë fshehur, ku kanë derdhur lot e janë mërzhitur, kanë mësuar ndoshta të jenë të lumtur për herë të parë.

Mejtepi - një rrënjë e rëndësishme për këtë fshat me një histori të pasur e me vlera kulturore ishte bërë i famshëm për qytetin e Istogut rreth 80 vite më parë, duke e kthyer vëmendjen tek vlera dhe funksionalizimi i tij.

Mësues në këtë mejtep/shkollë ka qenë Ismail Bajra. Kishte njerëz që vinin edhe nga vende të tjera të rajonit për të ndjekur mësimet këtu.

Mejtepi ka dy dhoma të cilat në të kaluarën kanë qenë të ndara për mysafirët dhe të pranishmit. Njëra dhomë shërbente për burra ndërsa tjetra shërbente për tu ushqyer, si dhe për kafe e çaj. Me të hyrë brenda tij, futesh në mendime të thella duke imagjinuar se si kanë mësuar këtu rreth 150 nxënës dhe si kanë mundur të mbanin orë mësimi.

Ky mejtep tashmë monument kulturor e arsimor, përmban në vete vlera të pa kontestueshme të sistemit arsimor në Kosovë, duke vendosur themelet e shkollës në fshatin tim.



11. Xhamia e Mehmet Akif Ersoj

Ndër objektet më të njohura në fshatin tone Shushicë, është Xhamia e Mehmet Akif Ersojit.

Ndërtimi i kësaj xhamie kishte filluar më 1855 (sipas kalendarit të hixhrit viti 1272) nga familja Mulaj dhe kishte përfunduar më 1861 (sipas hixhrit, që i bie viti 1278). Kësaj xhamie iu vu emri i djalit të Tahir Efendiut, Mehmet Akif Ersoj.

Tahir Efendiu u lind në vitin 1826 dhe ka jetuar në vendlindje deri në moshën 29 vjeçare. Në vitin 1885, ai udhëton për në qytetin e Stambollit për shkollim ku më pas ai duhej të kthehej në vendlindjen e tij për të punuar si imam i kësaj xhamie por nuk mundi të kthehej. Mehmet Akif Ersoj u lind më 20 dhjetor të vitit 1873, në Turqi. Ai në shkollë të mesme shprehu interesimin e tij për poezi ndërsa vepra e parë poetike të cilën e **lexoi ishte "Lejlaja dhe Mexhnuni"** nga Fuzuli. Në vitin 1888 babai i tij vdes duke krijuar vështirësi për familjen e tij. Këto vështirësi thellohen edhe më tej kur atyre iu digjet shtëpia. Mehmeti u detyrua ta braktiste shkollimin mirëpo ai kurrë nuk hoqi dorë nga poezia. Atij i shtohej edhe më shumë interesimi për poezi dhe kështu vazhdoi punën në këtë fushë. Poezitë e tij u botuan në gazeta

dhe revista të ndryshme. Ai gjithashtu ishte përzgjedhur që të shkruaj himnin kombëtar të Turqisë, të cilin e shkroi brenda 48 orëve, saktësisht më 12 mars të vitit 1921. Himni i Turqisë paraqet një pikë ujë në det në jetën dhe veprimtarinë e Mehmet Akifit. Të gjitha poezitë e tij i ka të **përmbledhura në veprën "Safaha"**. Mehmet Akif Ersoj ndërroi jetë më 27 dhjetor të vitit 1936 në Beyoglu të Stambollit. Fshati Shushicë krenohet me Tahir Efendiun dhe me Mehmet Akif Ersoj pasi populli turk i ka dhënë vend meritator atij, duke emërtuar shumë institucione me emrin e tij dhe duke i botuar veprat e tij po ashtu.

Në vitin 1999, gjatë luftës së fundit në Kosovë, xhamia në fjalë u dogj dhe pjesa më e madhe e saj u rrënuar nga forcat ushtarake dhe policore serbe. Në këtë gjendje të shkatërruar, xhamia kishte mbetur deri në fillim të punimeve restauruese në 2014. Restaurimi mbaroi në vitin 2015.






12. Xhamia në fshatin Tomoc

Pas presioneve të vazhdueshme të okupatorit serb për asimilimin e arsimit shqip por edhe të fesë islame, në vitin 1962, nga burrat e asaj kohe të fshatit Tomoc lindi ideja e ndërtimit të një xhamie.

Gjatë viteve të 90-ta, kjo xhami u përdor për mbajtjen e fjalimeve, mbledhje të këshillit të fshatit, diskutime për çështje kombëtare, vend-votim, etj. Gjatë viteve të 90-ta, pasi pushteti serb mbylli shkollat shqipe, u mor vendim që xhamia të shfrytëzohej si shkollë për klasë të ulëta e cila edhe u furnizua me mjete vetanake të banorëve, me participim sipas mundësive të asaj kohe.

Kjo shkollë në fshatin Tomoc ishte funksionale deri më 1998–99, pra deri në luftën e fundit të Kosovës. Gjatë luftës kjo xhami/shkollë u shkatërrua, mirëpo pas luftës xhamia u rindërtua dhe sot e kësaj dite mbetet objekti më vlerë për banorët e fshatit si trashëgimi e përcjellë brez pas brezi.

Ky objekt është i veçantë për ne sepse përveç që është xhami apo objekt kulti, kjo ishte edhe vatër e arsimit dhe edukimit të banorëve të fshatit, andaj ka një vend të vlefshëm në kujtimet tona.





13. Kisha e Shën

Gjonit

Në vendin tim ka shumë monumente të lashta historike, mirëpo, një e cila më bëri më shumë përshtypje është ajo në vendin ku unë jetoj, fshati Uqë. Kjo është Kisha e Shën Gjonit nga shekulli XVI-të ku themelet e saj përbëhen nga gurë të moçëm.

Kjo kishë në fillim përdorej nga shqiptarët, mirëpo, me okupimet dhe luftërat që u zhvilluan gjatë historisë, duke iu rezistuar në mënyrë të paparë tri sundimeve të mëdha siç ishte ajo otomane, gjermane dhe e fundit ajo serbe, së fundi kjo kishë përdoret nga serbët.

Kjo kishë nuk kishte vetëm funksionin e saj për kryerjen e ritualeve fetare, po ajo shpesh në kohërat e luftës ishte edhe një strehë e mirë për popullin në nevojë, ku cilësohej si shtëpi e Zotit e cila strehonte njerëz pa dallim feje a kombësie.

Kisha e Shën Gjonit është njëra ndër vlerat e shumta që ka vendi ynë, duke e shtuar numrin e objekteve më vlerë kulturore e historike.





Istog i Poshtëm : Kulla e Haxhi Buleshku
 Tre kate, e gurit e ndertuar në shek. XIX nga ustallarët
 fibran.

Kulla e Poshtem : The Tower of Haxhi Buleshku
 Three storey stone tower built in XIX century by masters
 of the third storey built with marble stone.

INSTITUTI QENDRORE I MONUMENTET
 BULEVARI "SHKURT" NR. 10, TIRANE

14. Kullat e Podgurit

Kullat si simbol kulturor dhe arkitektonik të Kosovës i gjejmë më së shumti në rajonin e Dukagjinit. Tek shqiptarët simbolizonte dhe vazhdon ta lë përshtypjen e rezistencës, frymëzimit, familjes, bashkimit dhe po ashtu edhe të dashurisë. Një kullë e madhe tri-katëshe, tradicionalisht ishte pronë e një feudali, apo të pasuri i cili kishte një familje të madhe shumë-anëtarëshe e që në atë kohë familjet e mëdha shkonin deri në 100 anëtarë.

Në rajonin e Podgurit, kullat zakonisht ishin të ndërtuara në tri kate dhe e tëra ishte e ndërtuar nga guri i gdhendur me dorë, me shumë kujdes nga mjeshtër të dalluar për këtë zeje.

Në shumicën e kullave, kati përdhese shërbente për vendosjen e bagëtive (ahur); në katin e parë vendosej apo ishte kati ku qëndronte familja, ku qëndronin kryesisht gratë dhe fëmijët; përderisa kulminacioni apo perla e një kulle tradicionale Podgurase dhe Dukagjinase gjendej në katin e dytë e që ishte Oda e burrave, e cila nga brenda punohej nga materiali i drurit dhe atë me shumë mjeshtëri e delikatesë. Aty qëndronin burrat që zakonisht në mbrëmje i zoti i shtëpisë iu jepte detyrat të tjerëve për punët që do ti bënin të nesërmen. Po ashtu në

oda të llojit të tillë mbaheshin edhe mbledhje të ndryshme nga ato që kishin për qëllim çështjen kombëtare, e deri tek pajtimi i gjaqeve por organizohej edhe pritja e miqve për ndonjë dasmë apo edhe për ndonjë rast mortor. Zakonisht Oda i kishte shkallët e ndara nga kati përdhese dhe kati i parë dhe kishte qasje nga pjesa e jashtme e ndërtesës.

Kullat ishin ndërtesa banimi të fortifikuara dhe tejet të qëndrueshme. Nëse një sulm i befasishëm që mund të ndodhte nga armiku, ato posedonin edhe frëngjitë. Frëngjitë janë hapje/dritare të vogla, të ngushta, e që shërbenin për të vëzhguar armikun potencial dhe në rast nevojë edhe për të gjuajtur me armë.

Familjet të cilat ishin të njohura për rezistencë dhe ishin gjithmonë në sy të keq për armikun dhe pushtetin e kohës kullat e tyre i ndërtonin në pjesë të larta apo në kodra që të kishin më të lehtë vrojtimin apo ardhjet e papritura që ndodhnin shpesh.

Kulla tradicionale është një pasuri e jona e cila vazhdon të ruhet si trashëgimi kulturore dhe e cila brenda vetes ka arkivuar kujtime të krenarisë, besës, bashkimit dhe fuqisë.



15. Ura e gurit:

“E di ti bija ime”

Qëndron në këmbë me dekada, vite e ndoshta edhe me shekuj dhe ajo është ura e gurit në Zallq. Ajo është urë që qëndron në këmbë më krenare se kurrë.

Kur shkova për herë të parë dhe pashë urën, ajo dukej shumë e bukur dhe mahnitëse por nuk mund të besoja se është aq e vjetër pasi kaloj çdo ditë mbi të. Thjesht ishte e pabesueshme. Të parët tanë e ndërtuan atë, tani në ecim mbi këtë urë dhe mahnitemi nga bukuria e saj. Jam shumë krenare që e shoh çdo ditë këtë **urë, t’ia prek gurët e lagur dhe t’ia prek themelet e saj.**

Teksa eci mbi të, një frymë më **godet sikur e më thotë: “E di ti çka ka ndodhur mbi këtë urë? Sa njerëz janë vrarë? Sa janë masakruar e kush është sakrifikuar? - Jo s’e di ti” më tha dhe filloj ti nxjerrë jashtë dhimbjet e saj, lotët e kalbur nga brenda.** Nxori gjithë urrejtjen, mërzinë, gëzimin e gjakun që kishte pirë me vite dhe më tha: **“Shiko bija ime, unë kam qëndruar në këmbë për kaq kohë, e di ti përse? – Jo, nuk e di” ia ktheva. “Mua më ndërtuan të parët tanë por më pas nga plagët, dhimbjet e gjaku më riparoi pushtuesi ynë shekullor otoman. E sa isha pranë tyre, ma prenë vëllain shqiptar mbi mua dhe e bënë kurban. Derdha lot, nxora vrer, qava, fsheha gjakun e**

tyre, fsheha gjithçka, i fsheha deri më tani. Kërkuan të mallkuarit para nga njerëzit që të kalonin mbi mua. Durova, durova, durova me vite të tëra edhe pse nga urrejtja plasa. Doja të hapësja e ti ngufatja në ujë. E di ti momentin më të vështirë që kam përjetuar? Kur ma hoqën zemrën mi hoqën shenjat, pasurinë time. Kur mi vranë vëllezërit e motrat e mija dhe i hodhën mbi mua të masakruar. Unë i mbylla sytë, **s’doja ti shihja qelbësirat që po ma vrisnin familjen. Sot unë qëndroj ende e forte bija ime sepse çdo ditë kuptoj se çfarë më ka ndodhur, çfarë më kanë bërë dhe paramendoj se çfarë do të më bëjnë”.**

Kjo urë është një monument me vlera të mëdha për trashëgiminë kulturore por edhe për atë historike, duke marrë parasysh vuajtjet të cilat i kemi kaluar si popull. Ajo duhet të ruhet edhe më shumë që mos të shkatërrohet, sepse duke e ruajtur ne mbrojmë dhe kultivojmë historinë tonë.



16. *Manastiri i* *Gorioqit*

Përveç monumenteve kulturore e historike siç janë: kullat, krojet, mullinjtë, xhamitë, si dhe monumentet tjera natyrore si: burimi i ujit të ngrohtë e të ftohtë, shpella, e shumë bukuri të tjera që posedon qyteti i Istogut, pjese e tyre është edhe Manastiri i Gorioqit.

Manastiri i Gorioqit gjendet në Gurin e Bardhë, mbi qytetin e Istogut. Duke u bazuar në traditën ortodokse, ky manastir ishte ndërtuar nga Mbreti Stefan i Deçanit dhe ia kishte dhuruar Shën Nikolasit si një shenjë mirënjohje që shëroi sytë e tij të djegur në atë vend. Gjithsesi, duke e mbështetur në traditën ortodokse që lidhet me shumë histori të tjera nuk është e mundur që ta dijmë saktë se cili ishte vendi ku mbreti shëroi sytë e tij. Kisha e vjetër e Shën Nikolasit në Istog, me shumë mundësi që ishte ndërtuar në shekullin e XIV por këto të dhëna nuk janë edhe shumë të sakta, pasi që janë vetëm të dhëna që qarkullojnë nga brezi në brez dhe se nuk janë të shënuara e të dokumentuara.

Ajo është rindërtuar në shekullin XVI dhe XVIII duke pasur një dhomë lutjesh pa afreske. Sot aty gjenden rreth njëmbëdhjetë vizatime (afreska) të ikonave ortodokse që janë punuar gjatë shekujve XVI, XVII dhe XVIII.

Në manastirin e Gorioqit sot jetojnë pesë motra të nderit dhe disa kryesues ortodoks të cilët janë në moshë të shtyer.

Manastirin gjatë vitit e vizitojnë shumë njerëz nga vendi dhe nga vende të ndryshme të botës. Lokaliteti mbrohet nga forcat Policore të Kosovës dhe nga forcat e KFOR-it Spanjoll, duke e mbrojtur kështu monumentin nga ndonjë sulm eventual dhe duke i shoqëruar pjesëtarët e manastirit për nevoja jetësore por edhe kanë udhëtime jashtë shtetit të Kosovës. Kjo ndodhë për arsye të frikës së tyre, dhe jo që ne do të donim apo do të mund ti bënim diçka, pasi që manastiri është pjesë e fshatit tonë ku të gjithë jetojmë se bashku.



17. Kulla e vjetër e Halil Mavrajt

Istogu si një nga vendet më të bukura dhe të qeta që ka Kosova, përveç i pasur me bukuri natyrore si me bjeshkët e bukura, me kullosat e livadhet, me ujëra të bollshëm, me pyje të bukura e me kafshë të egra, pra me një laramani të pasurisë natyrore, gjithashtu është i njohur edhe për shumë monumente kulturore të cilat janë trashëguara deri më sot. Këtu vlen të përmendet kulla e Halil Mavrajt e cila gjendet pikërisht në fshatin tim Saradran.

Ajo është ndërtuar që nga shekulli XIX-të e cila qëndron edhe sot e kësaj dite. Përveç ndërtimit të fortë nga guri dhe dritareve të vogla harkore në të gjinden edhe disa frenxhi të cilat janë përdorur për të vëzhguar nga brenda – jashtë dhe në rast sulmi nga armiku njerëzit brenda kullës kishin mundësi që nga kulla të kundërpërgjigjeshin.

Kulla ka një pamje të jashtme shumë të bukur gjë që vërehet edhe brenda saj. Kulla ishte në shërbim të fshatarëve për shumë vite. Është përdorur si odë burrash ku mblidheshin njerëzit për moment gëzimi siç ishin: dasmat dhe ahengje të tjera, e po ashtu mblidheshin edhe në raste mortore. Pikërisht në këtë odë janë mbledhur edhe për çështje politike e kombëtare.

Në katin e parë apo përdhese, banorët e kanë shfrytëzuar si ahur ku mbaheshin bagëtitë dhe ushqimi i bagëtisë.

Kulla ka pësuar dëme të mëdha gjatë luftës së vitit 1999, ku ushtria dhe policia serbe fillimisht kishin plaçkitur dhe shkatërruar të gjitha shtëpitë duke mos i anashkaluar as këto monumente të trashëgimisë kulturore ku fatin e njëjtë e kishe edhe Kulla e Halil Mavrajt.

Përkundër këtyre ngjarjeve fatkeqe, ato vazhdojnë të qëndrojnë në këmbë duke treguar kështu simbolikën e rezistencës dhe krenarinë shqiptare.



18. Hambari (Drithaniku)

Komuna e Istogut njihet si një nga regjionet tipike rurale, me tipare bujqësore, në pjesën më të madhe me prodhime të drithërave dhe me blegtori. Kushtet e mira si klima, tokat e pëlleshme, mundësia e ujitjes me ujin e lumenjve kanë bërë që banorët e kësaj ane të merren me zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj prodhimtarie.

Duke u marrë me bujqësi e blegtori, përveç objekteve të banimit siç ishin kullat, shtëpitë e zjarrit (shtëpia ku përgatitej ushqimi), u lind nevoja edhe për objektet tjera ndihmëse të cilat mund të shërbejnë për ruajtjen e drithërave, duke e zhvilluar kështu një ekonomi e cila siguronte nevojat e familjes.

Në komplekset e kullave tradicionale, gjendej edhe hambari (drithaniku), koshi dhe stallat e pojatat për strehimin e bagëtisë. Në oborre, këto objekte përcjellëse, në kuadrin e objekteve të banimit kishin një vend të caktuar dhe një renditje të planifikuar e të qëllimshme. Duke krijuar kështu një model të ngjashëm jo vetëm në mes familjeve të një fshati, por kishte ngjashmëri edhe mes fshatrave tjerë të regjionit etnografik të Podgurit si dhe më gjërë.

Drithaniku dhe koshi zinin vend para objektit të banimit, kullës, ku kryenin edhe funksionin e ndarjes së oborrit duke krijuar një lloj "havale". Në mes të hambarit dhe koshit zakonisht është lënë një hapësirë për kalim e cila shpesh mbyllet me një derë të vogël (kapigjik). Drithaniku cilësohej si objekti më me rëndësi nga gjitha objektet tjera përcjellëse-ndihmëse. Drithaniku punohej nga druri i pishës ose i bungut, në pjesën më të madhe punohej nga druri i pishës sepse nuk e dëmtonin insektet. Gjithashtu gjatë prerjes së drunjve kishte edhe një besim popullor, ku drunjte për ndërtimin e hambarit duhet të preheshin gjatë kohës së Hënës së vjetër e kurrsesi në fazën e ndërrimit të hënës.

Hambari kishte funksionin e strehimit të lashtave. Struktura e tij është zburuar me motive gjeometrike dhe forma të ndryshme përmes dru-gdhendjes. Si motive kanë dominuar ato solare dhe lunare që shprehnin plleshmërinë dhe shëndetin. Në pjesën e brendshme ishte i ndarë në vende të veçanta të dedikuara për frytet e caktuara bujqësore pastaj për fasule, grurë, misër, arra, elb, thekër, etj. Gjithashtu ka ekzistuar edhe një ndarje tjetër në të cilën vendosej mielli i grurit. Drithanikët dhe koshat e misrit ekzistojnë dhe ruhen me fanatizëm edhe në ditët tona, kryesisht nga familjet e fshatrave rrëzë maleve e sidomos ato që kanë tokë bujqësore dhe merren me këtë veprimtari.

19. Një tregim për fshatin tim, Vrellë

Duke u bazuar në të dhënat e hershme, trashëgimia kulturore buron nga gjenerata në gjeneratë, duke u bartur brez pas brezi qofshin ato trashëgimi monumentale, librat, ndërtesat apo edhe eposi popullor.

Sot ekziston një numër i konsiderueshëm i kullave të cilat mbartin në vete shumë rrëfime dhe bukuritë e rralla e të mahnitshme që shfaqin ato. Në këto vende janë lindur dhe janë rritur të parët tanë, stërgjyshërit, gjyshërit e deri te prindërit tanë dhe ne. Ata na e lanë amanet gjuhën shqipe, dashurinë për njëri tjetrin dhe trimërinë e besnikërinë e pa zëvendësueshme.

Unë jam lindur në fshatin Vrellë të Komunës së Istogut. Sipas të dhënave që kemi fshati Vrellë për nga popullata konsiderohet si fshati më i madh dhe më i gjerë në komunën e Istogut.

Në Vrellë ndodhet një shpellë e cila **njihet si "Shpella e Hoxhës"**. Brenda saj thuhet që gjenden disa pjesë me gurë të renditur në formë kalldrëmi, mbase ishin vende apo vatra të zjarrit. Aty po ashtu ishin gjetur disa fragmente atipike të enëve, të qeramikës parahistorike dhe të periudhës antike.

Përveç gjetjeve arkeologjike Vrella ka edhe natyrën e bukur e të begatshme përfshi këtu bjeshkët që njihen **me emrin "Lugu i Madh"**. Vrella në historinë më të re të Kosovës, e që përkon me kohën e luftës së fundit gjatë vitit 1999, lidhet ngushtë me ngjarjet që ndodhin në atë kohë në fshatin tim, ku kullat kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm.

Në atë periudhë, Kulla e Tahir Alisë ka mirëpritur ushtarët e UÇK-së nga Shala e Bajgorës. Një grup i ushtarëve të cilët qëndruan në këtë kullë ishin nën udhëheqjen e komandantit Rrahman Rama ku një ndër ta ishte edhe dëshmori Ismet Bicaj. Në këtë kohë edhe babai im me disa familje ishin bashkangjitur luftës së rezistencës.

Përderisa ne i shkruajmë këto vargje sot, kemi edhe histori të dhimbshme të pasqyruar në memorialin e 16 dëshmorëve të cilët kanë dhanë jetën për lirinë që ne e gëzojmë sot.

20. Shpella e Kamer Loshit

Fshati Syriganë (Suhogëri) gjendet 14 - 15 kilometra nga qendra e Istogut. Shumë studime dhe gjurmë të vjetra na qojnë tek informatat se ky fshat është shumë i vjetër. Që nga ajo kohë ka ekzistuar shpella e vjetër që emërtohet si shpella e Kamer Loshit, apo e njohur edhe si Bira e Kamberit.

Kjo shpellë gjendet në pjesën perëndimore të fshatit, mbi një kodër në lagjen e familjeve Kamberi, saktësisht në pronën e Enver Kamberit. Në të kaluarën, pronarët e tokës kanë vërejtur gjurmë të themeleve, por në ditët tona nuk vërehet ndonjë gjurmë tjetër përveç një hyrjeje të vogël. Thuhet se këtë shpellë në të kaluarën e kanë përdorur luftëtarët gjatë luftërave, duke ua mundësuar atyre një strehim dhe një pozitë më të mirë gjeografike e strategjike. Kjo informatë përmendet edhe sot nga banorët. Gjithashtu thuhet se kjo shpellë ka qenë një strehë e mirë edhe për tu fshehur nga armiku, duke pasur hyrje mjaft të vogël ka bërë që merimanga të thur rrjetën e saj. Në një rast, shpella kishte shpëtuar ushtarët të cilët kishin ngelur pa municion.

Fshati ynë në të kaluarën ka qenë e banuar me popullatë krishtere ortodokse dhe në atë kohë kishte pasur rreth 7 kisha ku edhe sot janë të dukshme disa nga gjurmët e tyre. Themelet e kishave i gjejmë edhe sot. Njëra është afër shtëpive të banimit, dy kisha të tjera tek vendi që quhet Krojet dhe dy të tjera në vendin e quajtur Bregu i Verdhë. Fakt është po ashtu se gjatë disa gjurmëve janë gjetur edhe dëshmi tjera të vjetra, si pllaka të mëdha guri të përpunuara.

Tregimi për këtë shpellë dhe lokalitetet tjera duhet të përcillen brez pas brezi tek të gjithë banorët e fshatit, por edhe më gjërë tek vizitorët.



21. Kulla, simboli

rezistencës

shqiptare

Istogu im, një qytet i vogël por me kulla të shumta... Kulla - një simbol rezistence e burrërie; simbol trimërie në zemrën e çdo shqiptari...

Teksa po shkruaj po mundohem të gjejë fjalët më të bukura për të përshkruar monumentet e qytetit tim, por fjalët më duket se humbasin në një oqean të pafund e unë mbetëm pa to dhe e humbur nga bukuria e tyre.

Kulla, një simbol që më së miri shpreh rezistencën dhe dashurinë shqiptare ndër shekuj. Një monument që sapo t'ia shohësh të bien ndërmend vuajtjet dhe kohërat e vështira që ka kaluar populli ynë. Vërtetë ishte një kohë trazirash, nën një kulm kulle po jetonin disa familje e po qanin hallet burrat e shtëpisë.

Sa herë u rrënuan, ato përsëri me dy duar të forta besnike u rindërtuan në vend ku jetuan me vite e vite. Muret e saj i ndërtuan vetë... siç thotë një fjalë "gurë gurë bëhet mur" e që për ne ishte një fjali mjaft shpresëdhënëse. Muret e reja përsëri po ndërtohen por si muret e simbolit të rezistencës s'besoj që do të jenë sepse u ngritën në kohën kur ne ishim më të bashkuar se kurrë. E sot kur po shikoj bukuritë e Istogut që

mbetën nga ajo kohë e zymtë ndjej krenari e njëkohësisht dhimbje për popullin tim.

T'ia fillosh të flasësh për kullat e bukura e të vjetra të Istogut do të duhej shumë kohë. Do të filloja nga Kulla e Selim Zenun Shatrit në fshatin Tomoc (në fotografi) e deri tek Kulla e Lashë Ukës në Kaliqan. Ndërtimi i tyre është i hershëm ashtu siç tregojnë edhe pasardhësit e tyre.

Kulla, vërtetë paraqet një simbol të rezistencës shqiptare që ndër vite jetuan aty e sot mbetën si një e kaluar historike e bukur.

Gjeneratat e ardhshme po mësojnë nga ajo e po e admirojnë të njëjtën kohë dhe nga tregimet e përcjella deri më sot dhe që po vazhdojnë të tregohen vite me radhë.



22. Xhamia në fshatin Kaliqan

Pikërisht në hyrje të fshatit Kaliqan, gjëja e parë që të rrëmben shikimin është xhamia e fshatit e cila supozohet që është ndërtuar dikur në shekullin e XIX-të.

Për nga struktura e mureve ajo ishte ndërtuar me gurë por nga dëmtimet e pësuar gjatë luftës së vitit 1999 të cilat ishin të thella, pas luftës kjo xhami iu nënshtrua një restaurimi të dukshëm dhe ndërroi plotësisht pamjen e brendshme dhe të jashtme të saj. Xhamia e Kaliqanit është një nga monumentet kulturore historike e fetare të shumta që ka Komuna e Istogut, e që sipas asaj që thuhet ky monument kulturi në vitin 1967 ka hyrë në listë nën mbrojtje të shtetit.


Xhamia për nga pamja dhe konstruksioni i saj, nuk ngjason me xhamitë e stilit otoman apo arab, por duke e marrë për bazë teknikën e ndërtimit ajo ka pamje tipi si të kullave shqiptare.

Kur themi se është e vjetër, këtë fakt nuk e fshehim dot, ngase në oborrin e xhamisë janë edhe varrezat, në mesin e disa pllakave të varreve kanë mbishkrimet në gjuhë otomane.

Ashtu siç duhet ndjekur traditat dhe zakonet tona për të mos i harruar asnjëherë, xhamia si objekt fetar shpie në një

rrugëdalje të bukur nëse e ndjekim gjatë gjithë jetës sonë. Për mua është vendi me të cilin krenohem se ekzistojnë akoma këto monumente kulturore të cilat janë ruajtur ndër vite.

Xhamia është monument i cili qëndroj kohës madje edhe luftës, ku për rezistencën e saj flasin vetë gurët e mureve që janë në strukturën e saj.





23. *Mulliri i Vrellës*

Monumentet e kulturës së një vendi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin ndër shekuj.

Një ndër monumentet e trashëgimisë kulturore të vendit tonë që daton nga shekulli i XIX-të është edhe Mulliri i Vrellës.


Ky mulli është një monument i trashëgimisë me vlera të lashta kulturore, arkitekturore, etnografike e historike. Ky mulli i ka shërbyer shumë rajonit për bluarjen e grurit dhe misrit dhe ka hyrë në funksion me anë të ujit. Mulliri bluan misrin me anë të dy gurëve. Godina e mullirit ka qenë e ndërtuar në formë katërkëndëshe, ku një pjesë e saj ka qenë mulliri dhe pjesa tjetër ka shërbyer për banim për pjesëtarët e familjes Bicaj.

Mulliri është djegur në vitin 1999, pra gjatë luftës së fundit në Kosovë, ndërsa për funksionalizimin e tij është kërkuar intervenim i menjëhershëm për rindërtimin e tij. Mulliri është aktiv dhe funksional edhe sot e kësaj dite dhe ruhet me fanatizëm nga trashëgimtarët.

Të gjitha monumentet kulturore kërkojnë kujdes të shtuar për shkak të vjetërsisë së tyre andaj kërkohet një përkujdesje e

veçantë për t'iu zgatur jetëgjatësinë e tyre për brezat e ardhshëm.

Monumentet e tilla na tregojnë për kulturën dhe traditat tona të trashëguara nga paraardhësit tanë, e kjo që të trashëgohet nga ne për gjeneratat tjera në vazhdimësi.





24. Kulla e Sali Osman Bicrit

Kulla e Sali Osman Bicrit është ndërtuar në fund të shekullit XIX-të, më saktësisht në vitin 1879 në fshatin Vrellë. Ndërtuesit e kullës ishin mjeshtrit dibranë, nga mjeshtrit më të sofistikuar në Ballkan për latim dhe muratim me gurë.

Kjo kullë edhe sot ka funksion banimi. Ndërtesa ishte vatër e përmendur për bujari, mikpritje e atdhetarizëm dhe strehë e burrave si: Bardh Isufi e Azem Galica. Ishte vend kuvendi për çështje atdhetare, dasma e ceremoni mortore. Në vitin 2012 është meremetuar (renovuar) nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Pejë.

Kati përdhe në të kaluarën shfrytëzohej për bagëti - lidhjen e kuajve, kurse tani është shndërruar për banim. Dera e kullës është e formës qemer e cila është e punuar nga druri i llojit bung, e armuar me teneqe hekuri dhe e mbyllur me drangun e derës hyrëse. Kati i parë fillon me korridorin ku lidhen dhomat e fjetjes për familjarë dhe që në gjuhën popullore emërtohen si "qilere". Frenxhitë shërbenin për të vëzhguar dhe për të sulmuar në rast sulmi nga jashtë për mbrojtjen e kullës nga ana perëndimore.

Oda e burrave dhe divan-hanja e kësaj kulle gjenden në katin e

dytë. Dera e odës është e punuar me ornamente florale përderisa dyshemeja dhe tavani janë të punuara nga druri i ahut dhe oxhaku nga mermeri. Në murin e odës mbi derë përreth ishte ngjitur "qivia" që shërbente për varjen e rrobave dhe armëve. Divan-hanja ishte vendosur kah ana veriore e kullës, ndërsa në anën lindore ishte avdes-hanja.

Kjo kullë kishte edhe funksionin mbrojtës nga armiku, pra me një fjalë rëndësia e saj është e madhe pasi bën pjesë në tempullin e vlerave etnologjike e arkitektonike të vendit tonë.






Uqë: Mulliri i Binak Kamberit, i ndërtuar
ne shek XIX.

Ukë: Vodenica Binaka Kambara, gradena
XIX veka.

Uqa: Mill of Binak Kamberaj, built
XIX century.

25. Mulliri me ujë

Quhem Vesa Kameraj dhe unë do të mundohem të shkruaj tregimin për trashëgiminë tonë familjare, për mullirin me ujë që funksionon qysh para 200 viteve e deri në ditën e sotme.

Sipas paraardhësve tanë: babë, gjysh, stërgjysh e të tjerë, në fshatin tonë kanë funksionuar shumë mullinj me ujë për bluarjen e misrit, grurit, elbit dhe thekrës. Në fshatin tonë (Uçë), gjithmonë sipas gojëdhënave të paraardhësve të mi, kanë ekzistuar diku përafërsisht rreth 33 mullinj. Në ditët e sotme, **fatmirësisht, duke i'u falënderuar** paraardhësve tanë, ekziston vetëm mulliri i familjes Binak – Rizë Kameraj. Unë jam shumë krenare që gëzojmë këtë pasuri familjare por dhe më gjërë.

Mulliri ynë punon me ujë i cili rrjedhë nga bjeshkët tona e që punon 24 orë apo të themi 365 ditë të vitit. Mulliri i shërben edhe fshatit tonë dhe rrethinës, por jo vetëm nga Komuna e Istogut, por edhe nga komunat tjera në Rajonin e Dukagjinit.

Mulliri ynë, pas luftës së fundit është renovuar tërësisht por gjithnjë duke e ruajtur konstruksionin e vjetër e të dikurshëm. Jam shumë falënderuese të gjithë atyre që kanë kontribuar për renovimin dhe rikonstruimin e tij dhe babait tim që e ruan këtë mulli me mjaft fanatizëm.

Mulliri ynë ka shumë vizitorë nga e mbarë Kosova dhe vizitorë të huaj nga shtetet tjera perëndimore të cilët shprehin kënaqësi dhe interesim të madh për të mësuar se si funksionon ky mulli me ujë. Unë jam shumë krenare që familja ime e ka ruajtur dhe mbikëqyrur këtë monument kulturor dhe njëkohësisht na sjellë të mira në familje duke na ndihmuar ekonomikisht.

26. Mulliri i Haxhi Shabanit

Ky mulli është i ndërtuar nga vet dora e Haxhi Shabanit së bashku me djemtë e tij të cilët ishin Januzi, Alia, Selmani dhe Veseli.

Gjyshi im, Idrizi, më rrëfen për ndërtimin e këtij mulliri kur ai ishte fëmijë dhe i kishte shikuar të parët e tij duke e ndërtuar. Gjyshi tregon po ashtu se si ata e kanë ndërtuar mullirin duke filluar nga muri me gurë të mëdhenj, që në atë kohë gurët i kishin marrë prej bjeshkëve me karroca kuajsh duke i bartur deri tek vendi i ndërtimit. Ky rrugëtim ishte shumë i vështirë pasi që rruga ishte e ngushtë dhe e thiktë me baltë, në kohë të shirave, gjë që e bënte edhe më të vështirë bartjen e gurëve. Në tregimin e tij, gjyshi rrëfen se si i kanë ndërtuar muret anësore dhe muret e përparmë me shumë mund.

Pasi që i kanë përfunduar muret kanë blerë gurët të cilët ishin posaçërisht për bluarje. Njëri ishte statik kurse tjetri lëvizës. Aty bluhej gruri dhe misri. Mbajtësi i drithit dhe miellit ishte i ndërtuar nga druri në formë piramide me maje të kundërt ku ajo e fundit bënte lëshimin e drithit gjatë rrokullisjes së gurit dalëngadalë në mënyrë që asnjë kokërr gruri apo misri të mos humbej por të bluhej e gjitha.

Mulliri ka qenë i gjerë rreth 5 metra dhe kishte një dhomë të

ndarë për drithin. Po në këtë dhomë ndodhej edhe një krevat për punëtorin që qëndronte aty.

Ky mulli ishte i ndërtuar afër lumit të quajtur Shushicë, por rrjedha e tij duhej të sillej pak më lartë se sa shtrati kryesor i lumit dhe kështu Haxhi Shabani me djemtë e tij e bënë të mundshme edhe një degë (jaz) që mundësonte rrjedhën e ujit të vinte drejt tek mulliri. Gjyshi thoshte se arsyeja pse është bërë kjo distance nga mulliri tek uji është për shkak se duhej që shtypja të ishte në drejtim të pjerrët që ta godiste fluturën e mullirit e cila është e ndërtuar nga metali në formë rrethore. Ajo rrokullisej nga çdo e rënë e ujit dhe kështu futej në funksion i gjithë mulliri. Sa më e madhe që është shpejtësia e lëvizjes së fluturës aq më e shpejtë bluante mulliri.

Pasi që mulliri kishte filluar të funksionojë, ai frekuentohej nga 8 fshatra përreth tij. Ky mulli ka sjellë përfitime familjare në atë kohë sepse për 100 kg miell të bluar 10 kg i ndanin për shtëpi dhe kështu përfitonte familja nga mielli i mbetur. Mulliri me ujë ka punuar pa kompensim e as edhe një qindarkë. Për ta ndaluar punën e mullirit është dashur të ndërpritet rrjedha e ujit.

Gjatë zhvillimit të luftës së Kosovës, mulliri u shkatërrua nga pushtuesit serb. Ata shkatërruan një nga burimet e jetesës së bashkëfshatarëve. Pas luftës ky mulli nuk është rindërtuar por ka mbetur në gjendje të shkatërruar.

27. *Kroi i etheve*

Ekziston një legjendë e thurur nga **vendasit rreth "Kroit të etheve"** që gjendet jo larg vendit ku jetoj.

Daton shumë e shumë vite më parë, para së të lindja unë duke u përcjellë nëpër gjenerata. Legjenda nisë me rrëfimin e një bariu i cili deri sa ishte me bagëtinë e tij takohet papritmas me një ari. Nga frika e madhe, atë e kaplojnë ethet, dhe rrugës, aty afër, sheh një krua ku ndalon për **të pirë ujë me shpresë që t'i largohen ethet**. Prej asaj dite, secili bari i cili ka kaluar andej pari, ka pirë ujë dhe ka lënë një cope tekstili apo rrobë të tij afër kroit i cili gjendet skaj rrënjës së një lisi trupmadh.

Vendi ku vazhdon të gjendet ky krua, edhe sot e kësaj dite, bart toponimin Starasellë e që në **gjuhën tonë përkthehet si "Fshat i Vjetër"**. Ky lokacion, në bazë të dhënave historike dhe rrënojave të gjetura nga arkeologët, ka qenë i banuar më parë, qysh në periudhën bizantine.

Tradita e vizitës së këtij kroi, vazhdon edhe sot, sidomos nga banorët vendas, por edhe nga të tjerët që gjatë rrugës së tyre për tu ngjitur në bjeshkët ndalojnë dhe shfaqin interesim qofshin për të shuar kureshtjen apo edhe për të mësuar rreth kësaj historie dhe **për t'u njohur më mirë më këtë krua**.

Pasi të mësojnë për legjendën ata shijojnë ujin dhe më pas marrin nga një fije peri apo cope nga rrobat e tyre dhe i lidhin në degët e lisit.

Në afërsi të këtij kroi rrjedh edhe një përrua i cili lëvizë qetë dhe vazhdon rrugën e tij drejt derdhjes në lumin e Istogut.



28. *Burimi i ujit të ngrohtë*

Komuna e Istogut cilësohet që ka pasuri të mëdha të trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore. Një nga monumentet e trashëgimisë natyrore dhe që e karakterizon Istogun dhe mbarë regjionin është Burimi i ujit të ngrohtë apo ujit termal në Banjë. Banja vizitohet nga shumë njerëz dhe turistë të huaj. Burimi i ujit të ngrohtë në Banjë është një nga burimet me veti shëruese që e bënë Istogun të veçohet nga qytetet tjera.

Të vjetërit apo gjyshërit tanë thonin se më parë Banja ka qenë vend vullkanik dhe këtë fakt ata e bazonin në formën kodrinore të saj. Po ashtu ata tregojnë se aty gjendej një pus me ujë të ngrohtë dhe veti shëruese, ku njerëzit **shkonin për t'u shëruar. Sot Banja** është si një lloj qyteze ku në zemër i buron uji i ngrohtë shërues. Përreth saj gjenden parqet e shumta, pyjet, shtëpitë, restorantet, hotele, shkolla, etj.

Duke filluar nga pylli dhe parku që e ka përreth, këto ambiente janë shumë të frekuentuara nga njerëzit. Përballë parkut gjendet hoteli tashmë i njohur, që i përdorë vlerat e mëdha shëruese të ujit të ngrohtë. Në këtë hotel ka shumë vizitorë dhe pacientë të cilët ndahen shumë të kënaqur me shërbime.

Banorët e kësaj ane janë njerëz të qetë e të ngrohtë. Zemër-ngohtësia e tyre ndoshta është edhe shkak i burimit të ujit të ngrohtë, ku i dihet :) Në përditshmëri, banorët dalin për ecje, shijojnë natyrën, darkojnë me familjet e tyre ku shijojnë çaste familjare në natyrë.





29. Bjeshka e Vojdullit

Bjeshka e Vojdullit gjendet në territorin e komunës së Istogut. Është pjesë integrale e vargmaleve të Moknes dhe ofron mundësi të shumta rekreative. Bjeshka e Vojdullit përbëhet nga majat, shkëmbinjtë, pyjet, kullosat dhe burimet e bollshme të ujit. Maja më e lartë quhet **"Maja e Madhe"**. Ngjitja në maje të ofron një pamje mjaft të mirë dhe relaksuese të një pjese të madhe të Kosovës përkatësisht rajonin e Rrafshit të Dukagjinit. Përballë Majës së Madhe qëndrojnë kërshat e vegjël që kanë një lartësi më të vogël. Ndër burimet ujore është **"Kroni i ftohtë"** i cili ka temperaturë shumë të ultë gjatë stinës së verës. Uji i këtij burimi ka një shije mjaft të mirë sa që disa njerëz i frekuentojnë këto vende vetëm për të pirë dhe marrë nga uji i tij. Nuk mbahet në mend ndonjëherë të jetë shterur ky burim. Përveç tij ka edhe shumë burime dhe kroje të tjera.

Kullosat e shumta që posedon kjo bjeshkë janë shfrytëzuar në të kaluarën, por edhe në ditët tona, për kultivimin e bagëtive, lopëve, deleve, dhive, etj. Ata që dalin me bagëtinë e tyre, dalin në fillim të pranverës dhe kthehen (zhdjergen) në fund të verës. Ata që kanë kasollet prej druri (stanet) i kanë livadhet e tyre të trashëguara nga paraardhësit e tyre.

Kohëve të fundit është rritur numri i atyre që po vizitojnë këtë bjeshkë, të cilët kënaqen me bukurinë dhe ambientin e saj. Vizitorët kryesisht janë familjarë, grupe miqsh, individë e turistë të huaj dhe që të gjithë ndahen të kënaqur me bukuritë e saj.

Pyjet e zbukurojnë dhe plotësojnë bukurinë e Vojdullit. Kohëve të fundit, një nga shkaqet shqetësuese është prerja masive e drunjëve, edhe këtu si gjithandej Kosovës që shkatërrohen pyjet.

Dëshira ime është që këto bukuri që ka kjo bjeshkë të ruhen dhe të mirëmbahen me kujdes të veçantë si nga banorët, vizitorët dhe nga shteti.



30. Lumi i Istogut

Qyteti i Istogut ka një pozitë të mirë gjeografike, duke e vendosur rrezë maleve ajo ka një rrjedhë të pasur hidrografike, pra të ujërave rrjedhëse mirëpo edhe të atyre nëntokësorë që dalin në sipërfaqe nëpërmjet burimeve të shumta e që në territorin e Istogut ka mjaft të tillë. Si ujëra rrjedhës apo lumenj, Istogu ka shumë të tillë duke filluar më atë të Drinit të Bardhë e deri tek disa lumenj apo përroska më të vogla.

Si një ndër lumenjtë më me rëndësi është edhe Lumi i Istogut. Ky lum ka luajtur një rol kyç për jetën e banorëve si në të kaluarën e deri më sot. Lumi i Istogut buron nga shkëmbinjtë mbi qytet, ndërsa burimi i këtij lumi cilësohet si mjaft i fuqishëm në territorin e Kosovës. Gjatë historisë ky lum ishte edhe një gjenerator i fuqishëm për krijimin dhe funksionimin e shumë mullinjve të cilët ishin ndërtuar përgjatë rrjedhës së lumit, përmes të cilëve u bë e mundur edhe bluarja e drithërave përkatësisht grurit dhe misrit, e që u shërbente jo vetëm banorëve të Istogut me rrethinë por u shërbente edhe vendeve tjera të regjionit.

Duke parë që rrjedha e këtij lumi është mjaft e shpejtë dhe e pastër, ishte e mundur edhe për zhvillimin e industrisë së peshkatarisë. Ky lum dallon nga lumenjtë tjerë sepse këtu kultivohet peshku i llojit trofta i cili konsiderohet peshk me kualitet të lartë. Ky fakt ka bërë që ky burim dhe kultivimi

i troftës të shndërrohet edhe në simbol të qytetit tonë. Përveç tjerash lumi furnizon shumicën e banorëve me ujë të pijshëm dhe ujitjen e një sipërfaqe të madhe të tokave bujqësore.

Qyteti i Istogut konsiderohet me fat që ka një lumë të tillë ngase sjellë shumë të mira dhe begati për Istogun dhe regjionin përreth, duke ndikuar në shumë aspekte si ekonomike, rekreative, etj andaj ne duhet të kemi kujdes në shfrytëzimin e tij. Pasuri të tilla natyrore duhet ruajtur me shumë fanatizëm.



31. Lisi plak

Komuna e Istogut ka monumente të shumta dhe mjaft me vlerë, por mua më pëlqen ky monument natyre i quajtur Lisi i Madh ose Lisi Plak, i cili është diku 580 veçar i vjetër.

Ky lis gjendet me lokacion në fshatin Trubohoc të Istogut. Në afërsi dhe rreth tij ekzistojnë shumë gjurmë të shumta të llaçit, gurë me forma të ndryshme të punuara dhe formësuar, pra që na jep të kuptojmë se aty kishte varreza të vjetra dhe ndoshta kishë katolike. Në disa dokumente përmendet poashtu se sipas informatorit Sali Ramë Çeta i cili ishte edhe gjyshi im, kur kanë ardhur këtu banorët e parë të familjes Mehmetaj nga Isniqi ata kanë gjetur një familje katolike shqiptare e cila më pas është zhvendosur nga fshati Trubohoc.

Sipas fjalëve të babait tim që mi ka treguar, thoshte se nganjëherë kur kemi gërmuar në afërsi të lisit kemi gjetur edhe shumë materiale të vlefshme ndoshta edhe me vlerë të madhe si dhe eshtra të njerëzve.

Ky lis shpeshherë shërbente edhe si vend pushimi ditor për burrat të cilët nën hijen e tij të madhe bënin pushim, kuvendonin për problemet dhe punët e fshatit: si punimi i tokës, ujitja etj. Banorët e fshatit kur kanë gëzim familjar, ndonjë dasmë, si shenjë që po fillon dasma apo gëzimi në familjen e tyre, krismat e para të tupanit binin pikërisht tek lisi. Por,

gjithashtu lisi ka shërbyer edhe si pikë takimi i banorëve të fshatit për të organizuar punët e tokës ngase nga toka ata jetonin dhe kishin të mirat bujqësore. Kishte edhe tubime politike apo për tu dalë në ndihmë banorëve të tjerë.

Vlen të përmendet se banorët këtë rit e kanë bërë edhe ditën kur u bë çlirimi i Kosovës. E dëshira ime është se edhe ne tani në këtë kohë të bëjmë takime qofshin ato për gëzime apo edhe për raste të tjera.

Pra, Lisi i Madh është një vlerë e shtuar e trashëgimisë sonë natyrore, ndërsa ne si banorë duhet të kujdesemi për të.



32. Burimi i Istogut

Jetojmë në një vend të vogël si Kosova me një vijë strategjike e gjeografike shumë të mirë, e të pasur me vende të bukura të cilat po ti shihnim të gjitha për një herë do të magjepsëmi. Ndër qytetet e Kosovës me bukurinë natyrore është edhe qyteti ynë Istogu.


Burimi i Istogut është atraksioni më i njohur i komunës sonë ku me të arritur aty do të hasësh në një bukuri e cila do të magjepsë sytë.

Uji i cili rrjedhë pa ndalur e bënë atë vend edhe më të bukur veçanërisht uji i cili buron nga shkëmbinjtë e bjeshkëve të kënaqin syrin me pamje aq mahnitëse. Uji është shumë i pastër nga aspekti i baktereve dhe për këtë ia vlen dhe ta provosh ta shijosh. Ky vend është i zhvilluar mjaft edhe nga aspekti turistik pasi ka lokacione për të pushuar, për të drekuar apo për tu freskuar me ndonjë pije.

Të gjithë ata që kanë dëshirën dhe vullnetin ta vizitojnë këtë vend do ta shohin që aty mund të ecësh lartë e më lartë pastaj do mund të shohësh të gjithë qytetin nga sipër përfshi këtu edhe shumë vende afër burimit të cilat veç sa ua shtojnë bukurinë vendit.

Istogu - një vend i vogël por me një burim kaq të bukur e të veçantë që ia vlen të vizitosh çdo herë.

Këto bukuri përveç se duhet të vizitohen dhe të shfrytëzohen për qëllime rekreacioni e pushimi, ne qytetarët por dhe vizitorët tjerë duhet të kemi kujdes dhe ta ruajmë ambientin përreth sepse në të kundërtën nëse hedhim mbeturina, shkatërrojmë ambientin e shkatërrojmë një aset të trashëgimisë natyrore, e që ua pamundësojmë brezave të ardhshëm të shohin dhe ti shfrytëzojnë këtë bukuri natyrore.





33. Bjeshkët e Istogut

Istogu është një qytet i vogël që shtrihet rrëzë bjeshkëve në anën veri-perëndimore, gjithashtu ka edhe plotë fusha të gjelbëruara.

Bjeshkët e Istogut kanë një sipërfaqe prej 45.348 ha. Ato janë një pasuri e bukuri natyrore, ndërsa uji i bjeshkëve të Istogut është një ndër ujërat më të mirë dhe të pastër, përfshi edhe ajrin që është mjaft i pastër e i shëndetshëm. Bjeshkët e Istogut janë shumë të vizituara, si nga vendorët por edhe të huajt.


Në këto zona ka shumë kafshë të ndryshme, shumë lloje frutash mali si manaferra, e shumë bimë të tjera. Gjatë verës bujqit i dërgojnë bagëtitë në kullota.

Vetëm për të parë bukurinë natyrore të burimit të Istogut vijnë vizitorë në grupe të mëdha apo edhe në grupe të vogla. Kur flasim për burimin e këtij qyteti të bukur, duhet të ndalemi edhe te restorantet ku gjatë gjithë kohës e sidomos gjatë sezonit veror vijnë plotë njerëz nga e mbarë Kosova dhe vende të tjera për tu ushqyer së bashku me familjet e tyre apo me shoqëritë. Një ndër restorantet e para është Trofta që mbetet akoma shumë e pëlqyer.

Istogu nuk është një qytet me ekonomi shumë të madhe por nëse bëhemi më të përgjegjshëm ne si qytetarë atëherë do të

gëzojmë një zhvillim edhe më të madh ekonomik dhe urbanistik.

Ky i fundit nuk ka ndonjë zhvillim të madh sepse akoma ka rrugë të pa asfaltuara por në të ardhmen pritet që të rregullohen dhe ato.





34. Shkëmbi dhe shpella e Shushicës

Fshati Shushicë shtrihet rreth 8 kilometra në lindje të Istogut. Pikërisht në këtë fshat gjendet një shkëmb në mes të pyllit. Shkëmbi rrethohet me drunj shkoze dhe drunj të llojeve të ndryshme. Po ashtu shkëmbi rrethohet me përroska të thella dhe në anën e sipërme dhe të poshtme kufizohet me dy rrugë. Rruga në anën e poshtme vjen nga fshati Shushicë dhe shkon deri të Bjeshka e Vojdollit, kurse rruga e sipërme të shpie në Bjeshkën e Buhavicës dhe Kosharishtës.

Në anën e poshtme të shkëmbit gjendet një shpellë. Kjo shpellë ka një hyrje prej dy metrash të lartë dhe një metër të gjerë ku sipas gojëdhënave të fshatarëve quhet **"Shpella e Shkëmbit të vogël"**. Deri më tani këtë shpellë nuk e ka hulumtuar askush deri në pjesën e fundit të saj. Sipas gojëdhënave të disa njerëzve që kanë hyrë brenda shpellës thonë se në shpellë ka shumë korridore dhe dhoma, ku hyrjet në dhoma janë shumë të ngushta dhe të vogla ku e zënë vetëm nga një person që duhet të ecë zvarrë. Kur futesh brenda në dhomë ato janë të mëdha dhe të errëta dhe diametri i tyre është nga tri metra deri në tetë metra dhe të larta tri deri në katër metra. Në të vërtetë, shpella nuk dihet se sa dhoma mund të ketë. Njëmbëdhjetë deri në pesëmbëdhjetë dhoma supozohet që i kanë vizituar fshatarët.

Dhomat kanë forma të ndryshme si p.sh: rrumbullake, katrore edhe të çrregullta dhe të cilat poashtu janë të larta. Dhomat në formë rrumbullake mendohet që janë të larta deri në shtatë metra ku mund të ecësh nëpër mure deri në pikën më të lartë ku nga poshtë duket si një dritare e madhe me dritë por kur të afroresh është një vrimë shumë e vogël ku depërton drita. Supozohet se kjo shpellë mund të jetë e gjatë deri në Bjeshkën e Pushtallës. Në shpellë mund të ketë gjallesa të ndryshme, si lakuriq, insekte etj.

Nëse je në shpellë dhe të fiket lampa apo bateria atëherë ju duhet të kërkoni ndihmë nga ndokush që është jashtë sepse është e pamundur të dalësh pa shikuar sepse është shumë errësirë dhe nëse ecë mund të largohesh edhe më shumë nga dalja.

Sipas disa arkeologëve, ky lokalitet ka gjurmë e sidomos në afërsi të kishës së vjetër mbi kodër ku u konstatuan disa gjetje të fragmenteve të qeramikës parahistorike të epokës së Bronzit të vonë dhe asaj të kohës së Hekurit.

Për të përmbyllur tregimin për të dëshmuar se fshati ynë është një vendbanim mjaft i lashtë e konfirmojnë edhe gjurmët e kishës së vjetër në oborrin e sotëm të familjes Hysenaj.



35. Trofta e Istogut

Territori i Komunës së Istogut njihet për nga rrjedhat e ujit e me pasuri të bollshme ujore. Këtë e përfaqësojnë shumë lumenj e burime natyrore të ujit, si në perëndim: Drini i Bardhë, Lumi i Istogut, i Vrellës, etj. Përveç këtyre vendi ynë ka edhe disa lumenjtë apo përroska disa të përhershme e disa sezonale, siç janë: Përroi i keq, Sushica, Kujavci, Bllagaça, Lumi Renovcit, etj.

Lumi kryesor është Lumi Istogut i cili rrjedhë nëpër Istog. Ky lum krijoi kushte të mira e të përshtatshme për krijimin e mullinjve, ujitjen e tokave bujqësore, për ujësjellësin, hidrocentralin por gjithashtu krijoj kushte të mira për Hurdhën apo kultivimin e peshkut.

Kultivimin e peshkut e bënë më së miri Kompleksi Trofta i cili gjendet në Istog. Duke pasur një traditë për kultivimin e peshkut dhe jo vetëm, ajo njihet edhe për restorantin, hotelin dhe ambientin e rregulluar brenda kompleksit. Duke e pasur një hapësirë me disa hektarë, dhe e pozicionuar pranë maleve të larta të Istogut, e bënë këtë ambient tepër tërheqës dhe joshës për vizitorët vendas dhe të huaj.

Uji i pastër dhe çdo herë i qarkullueshëm ka bërë që edhe peshku të rritet në kushte të mira, e pikërisht për shkak të kësaj peshku apo Trofta e Istogut është

më e kërkuara jo vetëm këtu por gjithandej Kosovës.

Me të hyrë në këto hapësira dëgjohet gurgullima e ujit, dëgjojnë edhe peshqit duke lëvizur e shpesh herë edhe duke kërcyer mbi ujë, fillon dhe e ndjen ambientin dhe freskinë e bjeshkëve. Kompleksi, pos specialitetit të saj, peshkun e troftës jep mundësi të shumta, duke bërë shëtitje apo duke u argëtuar, ku edhe fëmijët kanë hapësirat e përshtatshme me këndin e lojërave.

Kompleksi Trofta, tani për tani është kompania kryesore dhe me famë në mbarë Kosovën, ndërsa në Istog është pika kryesore dhe më e rëndësishmja e kësaj veprimtarie ekonomike. Është e njohur për vizitat familjare të fundjavës, ngase të largon nga përditshmëria, nga zhurma e makinave, stresi i punës, etj.





36. *Vendlindja e Presidentit historik Rugova*

Fshati Cerrcë është një vendbanim mjaft i rëndësishëm në komunën e Istogut, i njohur edhe me emrin Rranzë, këtë për shkak shtrirjes së tij rrezë malit të Mokrës. Fshati gjendet në veriperëndim të Kosovës në rrugën kryesore Istog-Pejë dhe jo më larg se 2 km larg qytetit të Istogut. Fshati njihet edhe si një vendbanim i vjetër, ku gjurmët e lashtësisë dhe prezenca e tumave Ilire japin dëshmi për këto. Ky fshat përbëhet prej një numri të konsiderueshëm të familjeve, ku disa prej tyre më të njohura kanë jetuar në kulla prej guri me disa kate. Këto familje me vatër të madhe cilësoheshin si simbol i pasurisë dhe fuqisë ku shpesh edhe ka pasur familje me mbi 40 anëtarë. Të ardhurat kryesore familjare kishin jo vetëm në bujqësi e produkte ushqimore, por edhe duke prodhuar veshmbathje dhe orendi apo edhe mjete të tjera që u kanë nevojitur.

Fshati Cerrcë pos lashtësisë së saj lidhet ngushtë edhe me historinë e Kosovës, gjegjësisht me një nga bijtë e saj më të ndritur të historisë së re të popullit tonë. Pikërisht në këtë fshat, nga një familje tradicionale u lind presidenti historik Dr. Ibrahim Rugova (2 dhjetor 1944). Familja e tij ishte me prejardhje nga fshati Malaj, Rugovë dhe fisi i lashtë i Kelmendit. Kishin mbiemrin Lajqi, të cilët më pas morën mbiemrin Rugova, në bazë të vendit të origjinës së tyre. Pas gati një muaji nga lindja e tij, komunistët jugosllavë ia pushkatuan të atin, Ukën dhe gjyshin Rrustë Rugova, që

kishte qenë luftëtar i njohur kundër çetave çetnike që po depërtonin në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Si një fëmijë i rritur vetëm nga nëna, ai arriti që me shumë sakrifica të përfundoj shkollimin e tij fillor, atë të mesëm në Pejë për të vazhduar fakultetin duke diplomuar në degën e Albanologjisë të Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Prishtinës në vitin 1971. Pos sukseseve të tij në shkollim Presidenti ynë njihet edhe si njeri i dijes dhe i paqes. Ai ishte autor i shumë librave si dhe kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Kjo shoqatë shpejt u bë bërthama kryesore e kundërshtimit paqësor të regjimit jugosllav në Kosovë. Si një intelektual me nam që i jepte zë kësaj lëvizje popullore, intelektuale e politike Dr. Ibrahim Rugova zgjidhet kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës në vitin 1989, partisë së parë politike demokratike që e sfidonte drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. I dekoruar nga shumë universitete e institucione ndërkombëtare, mund të veçojmë atë Doktor Nderi i Universitetit të Parisit VIII, Sorbonë, Francë (1996) dhe Çmimi Saharov për paqe i Parlamentit Evropian (1998).

Ibrahim Rugova ishte intelektual, politikan, akademik dhe shkrimtar shqiptar me titullin Doktor. Ai gjithmonë në veprimtarinë e tij politika punoi për liri, demokraci e pavarësi të Kosovës. Ai ishte Presidenti i parë i Republikës së Kosovës, duke shërbyer në vitet 1992–2000 dhe 2002–2006.

Vdiq më 21 janar të vitit 2006 pa e parë dhe përjetuar pavarësinë e Kosovës, për të cilën punoi gjatë tërë jetës së tij. Andaj, jo vetëm banorët e fshatit Cerrcë por gjithë qytetarët e Kosovës i janë falënderues jetës dhe veprës së tij.



37. Veshjet popullore tradicionale të Podgurit

Shumë studiues dhe njerëz që merren më këtë fushë gati çdo herë pajtohen se veshja në përgjithësi e sidomos veshja popullore në veçanti, është pjesa më e zhvilluar e një kulture dhe se gjithnjë shfaq burime kryesore të informative për jetën e njeriut. Veshja, sa është nevojë dhe domosdoshmëri po ashtu është bukuri dhe pasuri, mjeshtri dhe art, gëzim e pikëllim, etj.

Kosova si një tërësi territoriale etnografike e ndarë në disa zona apo rajone etnografike, është e pasur me një laramani dhe lloj-llojshmëri të veshjeve tradicionale e popullore, ku në tërësi veshjet popullore tradicionale kanë elemente dalluese në krahasim me veshjet e popujve të rajonit.

Gjithashtu dallojmë edhe përbrenda territorit tonë, shumë rajone që kanë veshjet me karakteristika apo elemente dalluese mes zonave të ndryshme etnografike. Këtu mund të cekim se veshja e Podgurit bën pjesë në kuadër të 140 formave të veshjeve popullore shqiptare sa njeh sot etnografia shqiptare.

Veshja popullore e Podgurit ka dallime në aspektin gjinor por ka dallime edhe në aspektin e moshës. Veshja e femrave dallon për nga moshja, statusi martesor etj. Për shembull në përbërjen e veshjes për femra kemi: Veshjen e plakave, veshjen e grave, nuseve dhe veshjen e çikave/vajzave. Pikërisht nga lloji i veshjes është dalluar edhe statusi i një femre. Edhe veshja e burrave ka dalluar në aspektin moshës, pra dallojmë veshjen e burrave, burrit të Podgurit, i cili elemente dallues kishte plisin në kokë, plisin me maje të rrumbullakët gjysmë-sferike, ku po ashtu vishej edhe mitani (këmisha), xhamadani, xhurdia, japanxhe (veshja e bariut), etj.

Përveç formave, materialit dhe funksionit të veshjeve popullore shqiptare dhe ato të Podgurit janë vazhdimësi e veshjeve të lashta ilire, duke u bazuar në motivet dhe ornamente e përdorura. Në veshje dallohen motivet apo ornamente gjeometrike siç janë, Dielli, rrethi, spiralja, etj. Po ashtu kemi edhe motivet e bazuara në vegjetacion, ku hasim, gjethet, hardhinë, etj. Paraqiten edhe motivet zoomorfe, siç janë zogjtë, fluturat, gjarpërinjtë, etj.

Veshja popullore tradicionale shqiptare dhe kjo e Podgurit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të tërësisë kulturore e materiale të etnokulturës shqiptare. Sot veshja popullore është larguar nga përdorimi i përditshëm, duke e përdorur vetëm me raste të caktuara.



38. *Plisi i* *mixhës Sylë*

Plisi quhet mbulesa e kapela prej leshi të cilën pellazgët, ilirët e më vonë shqiptarët e përdorën për ta mbuluar kokën.

Quhet plis sepse është e krijuar prej leshit të deles së bardhë (fisi ilir i delmatëve ose dalmatëve). Pra kapelë prej leshi, në dialektin gegë bënë pi-leshi ndërsa në gjuhën e vjetër bënë pi-lesi prej nga rrjedh pi-lisi dhe p'lisi e ku pastaj shkurtimisht e përfundimisht quhet plisi.

Punimi i plisit bëhet në mënyrë shumë të veçantë dhe jo shumë të thjeshtë. Plisi përbëhet nga leshi i cili duhet të punohet mirë e me kujdes të veçantë.

Edhe në fshatrat e krahinës së Podgurit mund ta shohim plisin i cili mbahet nga shqiptarët. Atë e shohim vetëm në kokat e burrave dhe pleqve, edhe pse në të kaluarën e kanë mbajtur edhe të rinjtë. Sot kjo traditë është zbehur dhe rrallëherë mund ta shohim të rinj me plis në kokë.

Mixha Sylë, është një ndër pak pleqtë që e mbanë ende plisin. Ai asnjëherë nuk është parë të ketë dalur pa plis në kokë. Kur e pyeta nëse e mban me mend se kur e ka vendosë për herë të parë ai u përmallua e filloi të më tregoj: **"Isha 12 vjeç, kur baba ma bleu një plis të ri dhe ma vendosi në**

kokë, e me tha: "Tash je rritë je bo burrë". Nuk e dija shumë rëndësinë e tij por më porositi: **"Sot e vendos në kokë plisin, dhe nuk duhet ta heqësh asnjëherë, se je shqiptar e ne e duam dhe e respektojmë atë që është e jona. Nga ajo kohë, si fëmijë, si djalë i ri, si burrë e edhe sot si plak e gjysh, asnjëherë nuk më ka shkuar mendja të dal pa të. Pasi që do ndihesha i turpëruar të dilja në rrugë pa plis. Duke u rritë e kam kuptuar edhe rëndësinë e plisit, pse është kaq i rëndësishëm për në shqiptarët e pse është ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi. Shumë kam pasur dëshirë që edhe djemtë e mi me e mbajt plisin, por ata jo që nuk më kanë ndëgjju por jeta dinamike dhe puna e tyre nuk ju ka mundësu. Megjithëse, nuk ankojem, ma bëjnë qefin nëpër festa e ceremoni që i kemi në familje".**



39. *Buka* *tradicionale*

Si tipar dallues i familjeve shqiptare, duke përfshirë edhe zonën tonë të Podgurit është mikpritja apo ofrimi i konakut për miqtë, bashkëfshatarët, fshatarët por edhe të trevave tjera kur ata i ka zënë terri. Si në mbarë territoret ku jetojnë shqiptarët edhe tek ne tradita popullore e familjare ka hapur dyert e konakut duke ju ofruar strehim e akomodim për një apo më shumë netë, referuar edhe shpesh me **thënien "bukë e krip e zemër"**. Familjet podgurase kanë hapur dyert për shumë njerëz edhe në raste të çështjes kombëtare, ku shumë burra janë mbledhur e kanë diskutuar për çështje të ndryshme kombëtare.

Duke u marrë në të shumtën e rasteve me bujqësi e blegtori, janë kultivuar shumë kultura bujqësore e sidomos misri dhe gruri. Kjo zonë njihet për prodhimtarinë e drithërave, e që krijonte elementin bazë për gatimin e bukës, bukës pogaçe, bukënores, bukës së kollomojt, etj. Duke u marrë me kultivimin e kësaj veprimtarie, qysh herët u lind nevoja për mullinjtë e ujit, meqë rrjedha e lumenjve ishte shumë e përshtatshme dhe kështu u krijuan kushte për ndërtimin e mullinjve për bluarjen e misrit dhe grurit.

Në ato shtëpi ku ofrohej konak për të tjerët ofroheshin të gjitha të mirat që kishte ajo shtëpi. Gjyshet, nënat dhe motrat tona kanë gatuar bukët më të mira, të gatuar me dashuri, të pjekura në furrë me dru. Buka dhe të gjitha bereqetet janë shtruar në sofrën tonë bujare. Buka çdo herë është gatuar me shumicë, ngase në ato kohë jetohej në bashkësi, kishte shoqërim e harmoni kur fillonte procesi i gatimit të bukës ku angazhoheshin shumë gra e vajza, duke i ndarë punët, dikush gatuate e dikush kujdesej për pjekjen e tyre. Përderisa po shkruaj këto rreshta më duket se e ndjej aromën dhe shijen e atyre bukëve.

Buka është një nga elementet esenciale të kuzhinës sonë dhe është gatuar çdo here në familjet shqiptare. Kjo traditë u trashëguar brez pas brezi e dorë më dorë duke qenë gjithmonë pjesë e pandashme e sofrës sonë. Buka gatuhet edhe në kohë të vështira ku njohim shumë raste kur gjyshet dhe nënat tona kanë gatuar bukë për luftëtarët tanë. Sot gatimi i bukës gatuhet e përpunohet në forma bashkëkohore, por asnjëherë duke mos e harruar formën tradicionale e autoktone.



40. *Darka e Lamës*

"Darka e Lamës" apo edhe **"Darka e fushës"** është pjesë e riteve të motmotit. Këto dhe shumë të tjera janë kremte-festa që në besimin popullor shënojnë ngjarjet e vitit si një trashëgimi e kulturës dhe e besimeve të lashta popullore.

Populli ynë, nga paraardhësit tanë ka trashëguar shumë doke e tradita të sakrificës, përkujtimit, gëzimit dhe falënderimit. Njëra nga këto është **"Darka e Lamës"** dhe është quajtur kështu sepse ka qenë ai vendi i rrafshët në fshatra malor, ku janë shirë (vendi ku merren të korrat) të korrurat, kryesisht të **misrit**. Ndërsa është quajtur **"Darka e fushës"** sepse pikërisht në fusha janë bërë të vjelat e saj dhe janë shirë të mirat, kryesisht të grurit. Përveç tjerash, kjo traditë cilësohet edhe si vend-gravitues i solidaritetit dhe i reciprocitetit mes fshatarëve shqiptarë, duke u dalë në ndihmë njëri-tjetrit.

Sikundër në krahinat e tjera etnografike, të cilat i kaploi vala e zhvillimit bashkëkohor në punë dhe në jetë të përbashkët komunitare, po ashtu edhe në rajonin apo krahinën etnografike të Podgurit tradita popullore pësoj ndryshime të mëdha. Kështu, nga gjithë ato ditë të shënuara të vitit, që kremtoheshin me ceremoni e ritual, mbijetuan kryesisht ato që kanë të bëjnë me punë, blegtorinë, bimësinë e shëndetin personal e familjar, por tejet të zbehta dhe shpesh të reduktuara.

Në të kaluarën "Darka e Lamës" u kremtonte me ceremoni e rite të ndryshme popullore. Tash e sa vite

kjo festohet në mënyrë simbolike duke e shënuar kështu mbledhjen e të korrurave (të lashtave) nga fusha. Gjithashtu kremtohet edhe zhdjergia (zbritja) e bagëtisë nga **"tabani"**, e shpesh herë këto dy festa shënohen në të njëjtën ditë. Në këto raste ftohen fqinjët, bashkëfshatarët, miqësia, punëtorët, barinjte për të festuar gjithë së bashku të korrurat, të vjelat dhe mbledhjen e bulmetit për atë vit.

Në rastin e "Darkës e Lamës", qytetarët e Istogut dhe mbarë Kosovës që njohin festat dhe falënderimet tradicionale, mbajnë mend këto festa kanë qenë dhe janë festa falënderimi për Zotin, natyrën dhe njerëzit përreth. Pra, kjo festë është tradicionale shqiptare e cila zakonisht shënohet në fund të muajit tetor, pikërisht atëherë kur janë korrë, vjelë të gjitha të mirat e punës verore.

Duke njohur rëndësinë e kësaj tradite, presidenti historik dhe tashmë i ndjerë Dr. Ibrahim Rugova **"Darkën e Lamës"** filloi ta zyrtarizoj duke e futur në agjendën shtetërore të Kosovës dhe për çdo vit më 24 tetor e organizonte këtë manifestim të cilën e konsideronte si një festë tradicionale popullore dhe familjare të Kosovës.

Për të festuar "Darkën e Lamës" zakonisht përgatiteshin shumë ushqime dhe pije, të gjitha specialitete nga tradita e trashëguar, dhe atë nga toka e bereqetshme e atij viti. Përveç përgatitjes së ushqimit, këngës e valles, bëheshin edhe falënderimet ndaj Zotit për të mirat e atij viti duke u lutur edhe për vitin pasues.

Për EC Ma Ndryshe

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror

është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e komprometuar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijës së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. *Paanshmëria* - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. *Aktivizmi* - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. *Orientimi drejt rezultateve* - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
4. *Komuniteti bazë e veprimit* - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.



Qershor 2020